Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Blerina Huruglica	**24.08.2023**	**28.08.2023**	**2023/0594**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 18.08.2023, **OE "Security Code"- Prishtinë,** ka parashtruar ankesë me nr: **2023/0594,** kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë **OE "Internal Security Association"SHPK**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Sigurimi fizik i objekteve te KEK-ut"** me nr. të prokurimit: "**KEK-23-4552-2-1-1"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: **2,780,159.38€.**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 7 i LPP (Barazia në Trajtim / Jo-diskriminimi)

Neni 11 i LPP par.3 nënpar.3.2 (Informata sekrete afariste)

Neni 28 i LPP par.6 (Specifikimet teknike)

Neni 57 par.4 nënpar.4.2 dhe 4.3 (Sigurimi tenderit)

Neni 59 i LPP par.2 dhe 4 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i tenderëve)

Neni 72 (Dokumentacioni dhe Informacioni shtesë)

Neni 7 i LPP (Barazia në trajtim / Jo-Diskriminimi)

Argument: Në dosjen e përgatitur të tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, AK ka bërë diskriminim të OE. Në njoftimin për tenderuesin e eleminuar dhe shkaqet që do të bashkangjitet bashkë me këtë ankesë, AK në raportin e vlerësimit të dytë njofton se ne nuk kemi ofruar dëshmi për përvojën e projektmenaxherit dhe mbikëqyrësit e rojeve. Në DT, AK nuk ka kërkuar kurrfarë dokumenti me të cilin do të paraqitet përvoja e projektmenaxherit dhe mbikëqyrësit të rojeve, por në bazë të kërkesave të MPB – Divizioni për Shërbimet Private të Sigurisë, në momentin kur një person kërkon të pajiset me licencë të Menaxherit kërkohet përvoja e punës 3-vjeçare për t'u pajisur me licencën adekuate, andaj ne si OE jemi bazuar në kërkesat e MPB dhe ofrimin e licencës valide si kërkesë dhe dëshmi për punëtorët e angazhuar për këtë aktivitet të prokurimit. Gjithashtu, AK në momentin e pranimit të tenderëve ka të drejtën të kërkojë sqarim të dosjes së tenderit nga OE për dokumentet të cilat nuk kanë qenë të ngarkuara dhe të cilat nuk do të shkaktojnë devijime të cilat mund të ndryshojnë DT.

Në analizën financiare të ngarkuar nga OE fitues vërejmë se ofertimi për shujtë është në vlerë prej 1.13€ kurse kërkesa e AK është që minimum të jetë 2.00€ (prova 1), ky ofertim padyshim që është diskriminues dhe jo ne harmoni me kerkesen e DT pasi që është e qartë dhe fakt notor që secili OE do të jetë më i ulët në çmim kur oferton nën vlerat dhe pragun që i ka vendosur AK. Gjithashtu, në sigurimin shëndetësor OE fitues ofertojnë me një çmim prej 8.00€ shumë e cila nuk mbulon as përqindjet më të vogla të sigurimit të kërkuar nga AK dhe me të cilin konstatohet se OE fitues ka ofruar sigurim shëndetësor sipas vullnetit të tyre të lirë dhe në kundërshtim me kërkesat e DT. Gjithashtu, paramarrëveshjet e OE tjerë pjesëmarrës me shumën mujore prej 7.50€ në muaj për punëtorë është shumë e habitshme dhe konfuze duke parë kërkesat e AK rreth sigurimit shëndetësor dhe specifikimive në tabelën e sigurimit shëndetësor, pasi që asnjë kompani e sigurimeve e rregulluar me tarifat e BQK nuk mbulon sigurim shëndetësor me shumë 7.50€. Tarifa minimale sipas BQK është 20.00€

Në analizën financiare të ngarkuar nga OE i dytë (Defence Security), në analizën financiare vërejmë se vlera e uniformës nuk është ngarkuar në analizë financiare pasi OE pretendon se ka uniforma të mjaftueshme për të gjithë punëtorët. Secili OE pjesëmarrës mund të deklarojë se ka uniforma të mjaftueshme për të siguruar për punëtorët me të gjitha kërkesat e AK, por kërkesat e AK janë të njëjta për të gjithë OE pjesëmarrës sepse ne Analizë Financiare kërkohet vlera totale e uniformës. Po ashtu, në këtë mënyrë duke mos llogaritur uniformën apo shpenzimet tjera të parapara OE tjerë mund të dalin fitues pasi çmimi final i tyre kuptueshëm është abnormalisht më i ulët. **(prova 2)**

Po ashtu depertamenti financiar i kompanisë e ka vërtetuar se pas analizimit të ofertave të të gjithë OE kanë ofertuar me çmim abnormal te ulët dhe nën pragun e vendosur nga AK per pagën bazë të caktuar 386.00€ dhe shtesat tjera ne harmoni me Ligjin e punes ne fuqi; 30% oret e nates; 50% ditet e festive si dhe pushimin me pagesë.

Referoju dosjes së tenderit, faqe 22 tek specifikimet teknike pika 4.

Neni 11 par.3 nën.par.3.2 (Informatat Sekrete Afariste)

Argument: Neni i parashtruar në LPP tregon se çka mund të konsiderohet si sekret afarist me të cilin edhe mbrohet ai sekret, është jo e drejtë kërkesa për konfidencialitet të të gjitha licencave dhe dokumenteve të kërkuara nga AK dhe kjo rrjedhimisht mbyll mundësitë për të parë nëse OE i përshtatet specifikave të kërkuara nga AK. Në programin e MPB (SSHPS) me numër të identifikimit personal mund të evidentosh secilin punëtorë që ka licencë valide gjithashtu datën e aplikimit, datën e statutit, llojin e shërbimit, numrin e certifikatës dhe të gjitha të dhënat tjera të cilat shërbejnë për nevoja të MPB, pra këto janë informata publike të cilat secili OE mund t'i përdorë dhe të ketë qasje pasi me këtë program kryhet aplikimi i të gjitha licencave që kërkohen nga MPB. Hiearkia ligjore në këtë rast i bie që AK të jetë zbatues dhe ekzekutues i normave legjislative dhe të veprojë në përputhshmëri me normat ligjore dhe rregullative të RKS. Andaj, të klasifikosh si sekret afarist pothuajse tërë dosjen e tenderit edhe pse në par.3 nënpar.3.3 tregohet shprehimisht se cilat informata mund të klasifikohen si sekrete ngrit dyshimet nëse OE fitues në këtë rast i plotëson të gjitha kushtet e nevojshme për t'u shpallur fitues.

Neni 28 par.6 (Specifikimet teknike)

Argument: Ne, si tenderues në këtë aktivitet të prokurimit kemi ofruar zgjidhje në mënyrë me plotësimin e kërkesave të definuara nga AK andaj eleminimi jonë nga ky tender nuk është adekuat pasi që edhe në arsyetimin e dhënë më lartë nga ne, OE "SECURITY CODE" SH.P.K arsyeton se ofrimi i kërkesave nga ana jonë është në përputhshmëri me kërkesat e AK. Kërkesat për ofrim të përvojës nga AK për mbikëqyrësit e zonave dhe projektmenaxherin përmbajnë: kontratë apo parakontratë, licencë valide, diplomë të shkollës së mesme, në përmbajtje të kësaj ne si OE kemi ngarkuar tri (3) kërkesat e AK dhe në kërkesë për përvojë kemi arsyetuar se AK do të bazohet në licencat e pjesëmarrësve të tenderit pasi që secili person që dëshiron të pajisjet me licencë të menaxheri duhet të ketë tri (3) vite përvojë pune në lëminë e sigurimit fizik, por kjo kërkesë neve si OE na ka vënë në lajthitje për shkak se në raportin e vlerësimit të dytë klasifikohen si lëshim nga ana jonë mos-ofrimi i përvojës së punës së personave pjesëmarrës në këtë tender dhe gjithashtu si OE jemi të gatshëm të dëshmojmë përvojën e secilit menaxher dhe secilit dokument të ngarkuar në momentin që AK kërkon duke qenë se kompania jonë operon nga viti 2008 në lëminë e sigurimit fizik dhe është e paarsyeshme dhe e njëjta shkakton dëmtim të imazhit të kompanisë nëse eleminimi jonë vie si shkak i mosparaqitjes së përvojës së punës edhe pse nuk është kërkesë e AK trusti apo vërtetimi. Sipas Ligji për Shërbimet Private të Sigurisë (Nr.04/L-004), neni 18 (Kushtet shtesë për licencimin e punëtorit të specializuar të sigurimit) paragrafi 5 cek:

Përveç plotësimit të kushteve të përcaktuara në nenin 15 të këtij ligji, menaxheri i sigurimit/zyrtari në detyrë duhet të plotësojë edhe këto kushte:

5.1. të ketë arritur moshën njëzetenjë (21) vjeçare;

5.2. të ketë tri (3) vjet përvojë pune në fushën e sigurisë;

5.3. të ketë përfunduar shkollimin e mesëm;

5.4. të ketë përfunduar me sukses trajnimin e specializuar për menaxher të sigurimit/zyrtar në detyrë dhe të posedojë certifikatën që e dëshmon këtë;

5.5. të ketë kaluar me sukses provimin e organizuar nga organi kompetent.

Rrjedhimisht lëshimi i licencës nga MPB për Menaxherët tonë është në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe arsyeton faktin e përvojës së kërkuar nga AK për projektmenaxherin 3 vite dhe për mbikëqyrësit e zonave 2 vite. Në mospërmbushjen e ofrimit të kontratave dhe referencave nga ne sipas AK, deklarojmë se vetëm me KEK kemi pasur bashkëpunim të mirë më shumë se 6 vite dhe me të njëjtin AK kemi lidhur kontrata të ndryshme, ku performanca jonë ka qenë serioze dhe efektive, këtë e vërtetojnë edhe referencat të cilat i kemi marrë nga AK.

(Kompania jonë vetëm në KEK ka operuar më shumë se 6 vite, të bashkangjitur gjeni referencat nga KEK).

Neni 57 par.4 nënpar.4.2 dhe 4.3 (Sigurimi i Tenderit)

Argument: Sigurimi i tenderit është verifikuar edhë një herë në kompaninë e sigurimeve përkatëse. Vlefshmëria e tij është 120 ditë. Po ashtu, mund të verifikohet në kompaninë e sigurimeve EUROSIG me Nr.policës 271/23. **(prova 3)**

Neni 59 par.2 dhe 4 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve)

Argument: AK në rastin e ekzaminimit të tenderëve vlerëson dhe krahason tenderët, gjitashtu në këtë proces mund të konstatojë edhe mungesat e nevojshme të cilat nuk janë ngarkuar nga OE pjesëmarrës për shkak të lëshimeve teknike, por që LPP siguron të drejtën e AK që t'i drejtohet OE pjesëmarrës për lëshimet të cilat janë evidentuar në "Kërkesën për sqarim të tenderit", me të cilën ne mund të kishim konstatuar lëshimet tona dhe eventualisht t'i ngarkojmë në platformën e-prokurimi për t'i ofruar AK të gjitha kërkesat të cilat nuk kanë qenë pjesë e tenderit të ofertuar nga OE por që janë kërkesa të cilat janë bërë nga AK. Gjithashtu, ne shohim se Zyrtarët për siguri dhe shëndet në punë nga OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, nuk përmbushin kërkesat e nevojshme për shkak se me datë 31.03.2023 ka qenë afati i fundit për paraqitjen e kërkesës për shtyrjen e afatit të validitetit të certifikatës, e gjitha kjo e bazuar me Rregulloren Nr.01/2021, përkatësisht në Dispozitat Kalimtare neni 37 par.1. Këtu përcaktohet se certifikatat e Ekspertëve janë valide për dy (2) vite nga hyrja në fuqi e kësaj rregullore dhe e cila ka hyrë në fuqi me datë 01.04.2021, dhe rrjedhimisht me këto dispozita rregullohet se zyrtarët të cilët nuk kanë ndjekur udhëzimet e nevojshme atëherë certifikata e tyre është e pavlefshme. Pra, ne vlerësojmë se ky krahasim i ofertave është i padrejtë dhe diskriminues ndaj tjerëve.

AK në e-mail zyrtar na ka dërguar linkun ku mund të verifikohen certifikatat e zyrtarëve për siguri dhe shëndet në punë dhe sipas këtij linku të gjitha OE i kanë të skaduara. Shiko linkun e bashkangjitur: https://mpms.rks-gov.net/ëpdm-package/lista-e-eksperteve-te certifikuar-per-sigurine-dhe-shendetin-ne-pune-2/ **(prova 4).**

Neni 72 (Dokumentacioni dhe Informacioni shtesë)

Argument: Marrë parasysh se AK ruan të drejtën për të kërkuar informatat shtesë dhe dokumentacionin e nevojshëm, ne si OE e shohim të papërshtatshme që vetëm disa OE të jeni të 'privilegjuar' për të dhënë informatat shtesë, duke parë se dokumentacioni jonë është krejtësisht i çështjes teknike dhe i cili nuk përbën asnjë ndryshim apo devijim nga DT, andaj

trajtimi nuk është bërë i barabartë dhe transparent ashtu siç kërkon par.1 i nenit 72.

Pra, në bazë të të lartcekurave dhe konform nenit 105 par.2.7 dhe 2.8, kërkojmë nga Bordi Drejtues i OSHP-së, që këtë aktivitet të prokurimit sikurse ceket në nënparagrafet e LPP, ta anulojë dhe të njëjtin t'a rikthejë në procedurë fillestare.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** **1.Kontratat e realizuara brenda 3 viteve te fundit** **2.Kualifikimet profesionale dhe edukative të stafit menaxheria** **3.Pajisjet - Veturat patrulluese** **4.Certifikatë të produkteve në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **1. Një listë të kontratave te realizuara nga tenderuesi në 3 vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate.** **2. Dëshmi që Menaxheri i Projektit posedon a. Diplomë të vlefshme Universitare, b. Përvojë 3 vjeçare në lëmin e sigurimit fizik, c. Licencën për Menaxher nga MPB-me në fushën e sigurisë fizike sipas Ligjit Nr. 04 L-004 për Shërbimet Private të sigurisë. Te dëshmohet me kopje te diplomës, kopjes se licencës dhe kontrate pune apo para kontrate. Dëshmi se zyrtari ngarkuar për siguri dhe shëndet ne pune posedon Certifikatat nga MPMS për dhënien e provimit profesional nga fusha sigurisë dhe shëndetit në punë, sipas ligjit NR. 04 L-161 PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË dhe aktevete ndërlidhura nënligjore. Te dëshmohet me kopje te certifikatës, dhe kontrate pune apo para kontrate. Dëshmi qe do te angazhohen jo me pak se 4 Mbikëqyrës (menaxhera) të Zonave. Ata duhet te posedojnë a. Minimum shkollim të mesëm, b. Te jene te certifikuar (licencuar) ne fushën e sigurisë sipas ligjit 04 L-004 dhe c. Se paku 2 vite përvojë në sektorin e shërbimit të sigurimit. Te dëshmohet me kopje te diplomës, kopje te licencës dhe kontrate pune apo para kontrate.** **3. Dëshmi qe tenderuesi posedon jo me pak se 4 (katër) vetura patrulluese te terrenit (4x4) . Te dëshmohet me kopje te certifikatave te regjistrimit te automjeteve (lejeve të qarkullimit).** **4. OE duhet t'i dorëzoj:** **Kopjet e Certifikatave EN-ISO 9001- 2015, EN-ISO 27001**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

KEK KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a. KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C. ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli: Sigurimi fizik i objekteve te KEK-ut

Numri i aktivitetit te prokurimit: KEK-23-4552-2-1-1
KEKO-23-184-211

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës
1.	"SAS" SH.P.K., dalip dalipi, 60 000, GJILAN	2627472.00
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik S.I.G. SH.P.K.; Group For Security SH.P.K., Mati 1 Rr. Muhamet Qame B-4-1, 10000, Prishtinë	2807612.70
3.	Grup i Operatorëve Ekonomik DEFENCE SECURITY SH.P.K.; International Security AAH SH.P.K., PRISHTINË, 10000, PRISHTINË	2746970.14
4.	Grup i Operatorëve Ekonomik Bold Security SH.P.K.; Drita Security Sh.p.k., Rruga Lidhja e Lezhës, nr. 97, 42000, Vushtrri	2617863.51
5.	Rojet E Nderit SH.P.K., Prishitnë, 10 000, Prishtinë	2776119.92
6.	"Internat Security Association"SH.P.K., Mustafë Kruja nr.3, 10000, PRISHTINË	2720579.85
7.	Security Code, MUHARREM FEJZA-BLL,III,HY.IV.LOK.15-1, 10000, PRISHTINË	3005114.50

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:
KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a. shpërblen me kontrate OE me te lire te përgjegjshëm "Internat Security Association"SH.P.K., ne vlere totale te ofertës **2,720,579.85** Euro me TVSH.

Me respekt,
Zyra Ekzekutive e Prokurimit
KEK – sh.a.

Letër standarde për *[tenderuesin]* e eliminuar [1]

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.,
Rr.Nëna Terezë, nr.36, 10000 Prishtinë

Security Code,
Kosovë, Prishtinë

Nr i prokurimit	KEK-23-4552-2-1-1
Nr i brendshëm	KEKO-23-184-211

Titulli: Sigurimi fizik i objekteve te KEK-ut

Të nderuar,

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *dosjen e tenderit*. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

ARSYETIM
Tenderi juaj është refuzuar për këtë arsye:

- Ju nuk keni prezantuar listën e kontratave dhe as referencat.
- Dëshmi që Menaxheri i Projektit posedon b. Përvojë 3 vjeçare në lëmin e sigurimit fizik- Mungon dëshmia për përvoja ne fushën e sigurimit fizik
- Sigurimi i tenderit është 119 dite e jo 120 dite sipas kërkesës ne DT
- Mungon dëshmia e përvojës se punës te mbikëqyrësit: Pika 2.c Se paku 2 vite përvojë në sektorin e shërbimit të sigurimit.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

Zyra Ekzekutive e Prokurimit
01/10/2023

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Security Code**

Sqarim hyrës:

Aktiviteti i prokurimit me titull " **Sigurimi fizik i objekteve te KEK-ut"** me nr. të prokurimit: "**KEK-23-4552-2-1-1"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a. ka filluar duke publikuar njoftimin për kontratë me datë 19.05.2023,me procedurë të hapur, kontratë publike kornizë me një operator ekonomik, lloji i kontratës Shërbim, kriteri i vlerësimit operatori me çmimin më të ulët, hapja e ofertave është bërë me datë 12.06.2023, njoftimi mbi vendimin e AK-së publikohet me datë 02.08.2023.**

OE ankuesi pretendon se AK nuk ka vlerësuar drejtë ofertat, duke shkelë dispozitat ligjore përkatësisht nenet 7, 11, 28, 57, 59, 72 të LPP-së.

Vlerësimi i pretendimit të OE ankues lidhur me eliminimin:

Pretendimi i parë:

Argument: *Në dosjen e përgatitur të tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, AK ka bërë diskriminim të OE. Në njoftimin për tenderuesin e eleminuar dhe shkaqet që do të bashkangjitet bashkë me këtë ankesë, AK në raportin e vlerësimit të dytë njofton se ne nuk kemi ofruar dëshmi për përvojën e projekt menaxherit dhe mbikëqyrësit e rojeve. Në DT, AK nuk ka kërkuar kurrfarë dokumenti me të cilin do të paraqitet përvoja e projekt menaxherit dhe mbikëqyrësit të rojeve, por në bazë të kërkesave të MPB – Divizioni për Shërbimet Private të Sigurisë, në momentin kur një person kërkon të pajiset me licencë të Menaxherit kërkohet përvoja e punës 3-vjeçare për t'u pajisur me licencën adekuate, andaj ne si OE jemi bazuar në kërkesat e MPB dhe ofrimin e licencës valide si kërkesë dhe dëshmi për punëtorët e angazhuar për këtë aktivitet të prokurimit. Gjithashtu, AK në momentin e pranimit të tenderëve ka të drejtën të kërkojë sqarim të dosjes së tenderit nga OE për dokumentet të cilat nuk kanë qenë të ngarkuara dhe të cilat nuk do të shkaktojnë devijime të cilat mund të ndryshojnë DT.*

Përgjigje në pretendimet e OE ankues lidhur me arsyen e eliminimit nga AK:

Eksperti Shqyrtues pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, në ofertën e OE ankuesit janë të ngarkuara, deklarata mbi projekt menaxherin, licenca valide për siguri dhe shëndet në punë, po ashtu edhe kontratën e punës, mirëpo AK ka eliminuar OE ankuesin që nuk ka bashkangjitur përvojën e punës, e cila mundet të sqarohet konform nenit 72 të LPP-së, po ashtu edhe sipas Ligjit për shërbime private të sigurisë secili aplikues për licencë duhet të posedoj përvojë pune varësisht nga natyra. Dhe si e tillë **sa i përket Projekt menaxherit pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

Pretendimi i dytë i OE ankues kundër OE të rekomanduarit:

Në analizën financiare të ngarkuar nga OE fitues vërejmë se ofertimi për shujtë është në vlerë prej 1.13€ kurse kërkesa e AK është që minimum të jetë 2.00€ (prova 1), ky ofertim padyshim që është diskriminues dhe jo ne harmoni me kerkesen e DT pasi që është e qartë dhe fakt notor që secili OE do të jetë më i ulët në çmim kur oferton nën vlerat dhe pragun që i ka vendosur AK. Gjithashtu, në sigurimin shëndetësor OE fitues ofertojnë me një çmim prej 8.00€ shumë e cila nuk mbulon as përqindjet më të vogla të sigurimit të kërkuar nga AK dhe me të cilin konstatohet se OE fitues ka ofruar sigurim shëndetësor sipas vullnetit të tyre të lirë dhe në kundërshtim me kërkesat e DT. Gjithashtu, para marrëveshjet e OE tjerë pjesëmarrës me shumën mujore prej 7.50€ në muaj për punëtorë është shumë e habitshme dhe konfuze duke parë kërkesat e AK rreth sigurimit shëndetësor dhe specifikimive në tabelën e sigurimit shëndetësor, pasi që asnjë kompani e sigurimeve e rregulluar me tarifat e BQK nuk mbulon sigurim shëndetësor me shumë 7.50€. Tarifa minimale sipas BQK është 20.00€

Eksperti shqyrtues lidhur me pretendimin e rradhës të OE ankues sqaron se, në ofertën e OE të rekomanduar, gjendet paramasa mbi çmimin ofertues, dhe si rrjedhojë vërejmë se, pas kërkesës për sqarim nga ana e AK-së për të gjithë operatorët, në të cilën kërkesë AK kërkon që të bashkëngjiten analizat financiare, dhe si e tillë në E-prokurim me datë 20.06.2023 nga OE i rekomanduar është bashkangjitur analiza financiare, ku shihet se OE i rekomanduar ka kalkuluar shujtën e punëtorëve me çmimin 1.13 euro, gjerësa AK në DT ka kërkuar që shujta mos të jetë më e ulët se 2 euro, andaj **pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

Kurse sa i përket pretendimit për ofertuesit të cilët kanë kalkuluar sigurimin shëndetësor në vlera 6 euro, 7.5 euro, 8 euro, konsideroj se gjendet e bazuar, për faktin se personalisht kam hulumtuar çmimet dhe si rrjedhojë kushtojnë mbi 20 euro, mirëpo AK sugjerohet që të hulumtoj tregun, andaj **pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar**.

Kërkesa e AK-së në DT:

10. Për shujte dhe sigurim shëndetësor, OE është i obliguar qe para nënshkrimit te kontratës te sjell marrëveshjet paraprake për:

- Për sigurim shëndetësor me një kompani për sigurim shëndetësor
- Për shujte me një ofrues te shërbimeve te ushqimit. (kosto e shujtës ditore nuk mund te jete me e ulet se 2.00€)

Vërejtje: Autoriteti Kontraktues gjate realizimit te kësaj kontrate do te monitorojë përcjellë ne mënyre strikte përmbushjen e te gjitha kërkesave te specifikimit teknik si dhe deklaratave te dhëna ne oferte. Ne rast te dështimit te respektimit te këtyre kërkesave nga OE, Autoriteti Kontraktues do te marre masat e parapare ligjore qe i parasheh kontrata për rastet e tilla.

Analiza financiare e OE të rekomanduarit:

Analiza Financiare e OE të rekomanduarit:

ANALIZA FINANCIARE
INTERNATIONAL SECURITY ASSOCIATION SH.P.K
Punetor nderrimi I 2

Paga per nje punetor	386	Shpjegim I kalklulimit
oret e nates	12.95	oret e nates per nderrimin e dyte nga 2 ore per cdo nate duke pas parasysh se gjithsej ore nate
festa	8.8	per nje punetor jane 176/3 58.87 ore , dhe ora me 30% I bie 0.66 euro per pagen 386/176
Pushim vjetor	29.53	qe per nje muaj eshte 58.87*0.66 mbi oren baze 100% = 38.85 euro ne muaj
total	437.28	ateher kur nje punetor punon nga 2 ore brenda muajit 58.87/3 punetor I bie 30% mbi oren baze 100 %
kontribut punedhenesi	21.86	19.62 ore apo 12.95 euro per 2 ore pune apo 25.90 euro per 6 ore pune te nderrimi I trete qe ne total
total me kontribut	459.14	58.87*0.66 38.8542 12.95+25.90=38.85
shujta	34.47	
sigurim shendetsor	8	Kalkulimi I festave gjithsej festa zyrtare 11 apo 12 dite ne vit qe mesatarisht I bien 8 ore per cdo muaj
uniforma	5	muaj nje punetor kurse 386/176 * 50% e ores baze 1.1 euro 8*1.1=8.8 euro mbi oren baze
total me shpenzime	506.61	
123.67 punetor ndrrim dyte	**62652.95**	Pushimi vjetor mesatar 28 dite = 29.53 euro apo 386/30.5*28/12 muaj
Punetor ne nderrimin e 3		Shujtat Prej 371 puentoreve ne nderrim 247.34 1.69 418.0046 418.00 euro pjestu per 371 punetor
Paga per nje punetor	386	duke pas parasysh se ne kemi llogarit oret per 371 punetor I bie 418/371 = 1.13 euro per cdo dite per shujte
oret e nates	25.90	1.13*30.5 34.47 euro ne muaj per cdo punetor
festa	8.8	
Pushim vjetor	29.53	Sigurimi shendetsor 8 euro ne muaj edhe pse ne kemi oferte me 7.5 euro
total	450.23	
kontribut punedhenesi	22.51	Uniforma edhe pse ne kemi marre oferte me 30 euro per te dy uniformat ne kemi kalkulu 60 euro uniformat
total me kontribut	472.74	e kerkuara nga AK.
shujta	34.47	
uniforma	5.00	Pas tere kalkulimeve ne kemi ardhe ne perfundim te cmimit si eshte I dhene ne fund te tabeles mirepo pjesen tjeter
sigurim shendetsor	8	e kemi lene per fitim te kompanise.
total me shpenzime	520.21	
123.67 punetor nderrimi I 3	**64334.92**	
Punetor per nderrim te pare	**386**	
Pushim vjetor	29.53	

Pretendimi i tretë kundër OE "Defence Securty"SHPK:

Në analizën financiare të ngarkuar nga OE i dytë (Defence Security), në analizën financiare vërejmë se vlera e uniformës nuk është ngarkuar në analizë financiare pasi OE pretendon se ka uniforma të mjaftueshme për të gjithë punëtorët. Secili OE pjesëmarrës mund të deklarojë se ka uniforma të mjaftueshme për të siguruar për punëtorët me të gjitha kërkesat e AK, por kërkesat e AK janë të njëjta për të gjithë OE pjesëmarrës sepse ne Analizë Financiare kërkohet vlera totale e uniformës. Po ashtu, në këtë mënyrë duke mos llogaritur uniformën apo shpenzimet tjera të parapara OE tjerë mund të dalin fitues pasi çmimi final i tyre kuptueshëm është abnormalisht më i ulët. (prova 2) Po ashtu depertamenti financiar i kompanisë e ka vërtetuar se pas analizimit të ofertave të të gjithë OE kanë ofertuar me çmim abnormal te ulët dhe nën pragun e vendosur nga AK per pagën bazë të caktuar 386.00€ dhe shtesat tjera ne harmoni me Ligjin e punes ne fuqi; 30% oret e nates; 50% ditet e festive si dhe pushimin me pagesë.

Eksperti Shqyrtues lidhur me pretendimin e radhës sqaron se, OE i dytë (Defence Security) ka të bashkangjitur analiza financiare, pas kërkesës për sqarim nga AK, dhe si e tillë OE në fjalë ka të bashkangjitur analizën, kurse për uniformat i njëjti ka dhënë sqarim më poshtë, mirëpo është në diskrecion të AK-së të kërkoj sqarime nëse ka çmim abnormalishtë ulët.

Pretendimi i katërt i OE ankues lidhur me eliminimin e tyre nga AK:

Në mospërmbushjen e ofrimit të kontratave dhe referencave nga ne sipas AK, deklarojmë se vetëm me KEK kemi pasur bashkëpunim të mirë më shumë se 6 vite dhe me të njëjtin AK kemi lidhur kontrata të ndryshme, ku performanca jonë ka qenë serioze dhe efektive, këtë e vërtetojnë edhe referencat të cilat i kemi marrë nga AK. (Kompania jonë vetëm në KEK ka operuar më shumë se 6 vite, të bashkangjitur gjeni referencat nga KEK)

Eksperti Shqyrtues, sa i përket arsyes tjetër të eliminimit lidhur me listën e kontratave dhe referencave sqaron se, në ofertën e OE ankues nuk gjendet lista e kontratave të realizuara brenda tri viteve të fundit, dhe si e tillë konform udhëzuesit Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, meqenëse nuk posedon Listë të kontratave atëherë refuzohet tenderi.

Problemi	**Si të veprohet?**	**Neni i LPP-së**
Mungon referenca/certifikata e pranimit nga lista e kontratave të prezantuara	Mund të kërkohen informata sqaruese	69
Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës se përcaktuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69
Lista e kontratave të realizuara nuk është dorëzuar por janë dorëzuar Dëshmitë (referenca/certifikata e pranimit/kontrata)	Mund të kërkohen informata sqaruese	69

Kërkesa e AK-së në DT pika 1.:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** **1.Kontratat e realizuara brenda 3 viteve te fundit** **2.Kualifikimet profesionale dhe edukative të stafit menaxheria** **3.Pajisjet - Veturat patrulluese** **4.Certifikatë të produkteve në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **1. Një listë të kontratave te realizuara nga tenderuesi në 3 vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate.** **2. Dëshmi që Menaxheri i Projektit posedon a. Diplomë të vlefshme Universitare, b. Përvojë 3 vjeçare në lëmin e sigurimit fizik, c. Licencën për Menaxher nga MPB-me në fushën e sigurisë fizike sipas Ligjit Nr. 04 L-004 për Shërbimet Private të sigurisë. Te dëshmohet me kopje te diplomës, kopjes se licencës dhe kontrate pune apo para kontrate. Dëshmi se zyrtari ngarkuar për siguri dhe shëndet ne pune posedon Certifikatat nga MPMS për dhënien e provimit profesional nga fusha sigurisë dhe shëndetit në punë, sipas ligjit NR. 04 L-161 PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË dhe aktevete ndërlidhura nënligjore. Te dëshmohet me kopje te certifikatës, dhe kontrate pune apo para kontrate. Dëshmi qe do te angazhohen jo me pak se 4 Mbikëqyrës (menaxhera) të Zonave. Ata duhet te posedojnë a. Minimum shkollim të mesëm, b. Te jene te certifikuar (licencuar) ne fushën e sigurisë sipas ligjit 04 L-004 dhe c. Se paku 2 vite përvojë në sektorin e shërbimit të sigurimit. Te dëshmohet me kopje te diplomës, kopje te licencës dhe kontrate pune apo para kontrate.** **3. Dëshmi qe tenderuesi posedon jo me pak se 4**

Pretendimi i pestë i OE ankues lidhur me eliminimin e tyre nga AK:

Argument: Sigurimi i tenderit është verifikuar edhë një herë në kompaninë e sigurimeve përkatëse. Vlefshmëria e tij është 120 ditë. Po ashtu, mund të verifikohet në kompaninë e sigurimeve EUROSIG me Nr.policës 271/23.

Eksperti Shqyrtues sa i përket arsyes tjetër të eliminimit të OE ankues lidhur me sigurimin e tenderit sqaron se, i njëjti ka të bashkangjitur sigurimin, e cila ka validitet të shkruar nga vet kompania e sigurimit Eurosig, mirëpo AK mundet ta verifikoj tek kompania në fjalë nëse ka dyshime, dhe si e tillë pretendimi gjendet pjesërisht i bazuar.

EUROSIG
KOMPANI SIGURIMESH

07533

Për: KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues")

Në emër të: Security Code SH.P.K, Prishtine, Prishtinë
(në vazhdim "operatori ekonomik")

Titulli i aktivitetit të prokurimit: SIGURIMI FIZIK I OBJEKTEVE TE KEK-UT

Numri i prokurimit: KEK-23-4552-2-1-1 (numri i brendshem KEKO-23-184-211)

SIGURIA E TENDERIT
Garancion
Nr.Serik i polices: 217/23

DERISA tenderuesi ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri tenderi duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;
DHE NGASE tenderuesi dëshiron të depozitojë garancinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;
DHE NGASE NE jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci:

ANDAJ NE, me këtë konfirmojmë se jemi Garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të tenderuesit, deri në një total prej: **30,000.00 (tridhjetë mijë Euro)** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

(a) Autoriteti kontraktues konstaton, në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht, se ai tenderues i ka dhënë informacione përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese Autoritetit Kontraktues;
(b) Tenderuesi tërheq tenderin e tij pas skadimit të afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, por para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit të përcaktuar në Dosjeje të Tenderit;
(c) Tenderuesit i është dhënë kontrata në fjalë në bazë të tenderit të tij dhe tenderuesi refuzon apo dështon:
- Që të depozitojë sigurinë e ekzekutimit të specifikuar në Dosjen e Tenderit;
- Të plotësojë të gjitha kushtet që i paraprijnë nënshkrimit të kontratës në fjalë siç është përcaktuar në Dosjen e Tenderit; apo
- Të lidhë kontratë që u përshtatet afateve dhe kushteve të saktësuara në dosjen e tenderit;

Pagesa në shumën e limituar prej: **30,000.00 Euro** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vërtetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri është e vlefshme 120 ditë prej 12.06.2023 deri më 09.10.2023

Pretendimi i gjashtë i OE ankues lidhur me validitetin e certifikatave :

Argument: *AK në rastin e ekzaminimit të tenderëve vlerëson dhe krahason tenderët, gjithashtu në këtë proces mund të konstatojë edhe mungesat e nevojshme të cilat nuk janë ngarkuar nga OE pjesëmarrës për shkak të lëshimeve teknike, por që LPP siguron të drejtën e AK që t'i drejtohet OE pjesëmarrës për lëshimet të cilat janë evidentuar në "Kërkesën për sqarim të tenderit", me të cilën ne mund të kishim konstatuar lëshimet tona dhe eventualisht t'i ngarkojmë në platformën e-prokurimi për t'i ofruar AK të gjitha kërkesat të cilat nuk kanë qenë pjesë e tenderit të ofertuar nga OE por që*

janë kërkesa të cilat janë bërë nga AK. Gjithashtu, ne shohim se Zyrtarët për siguri dhe shëndet në punë nga OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, nuk përmbushin kërkesat e nevojshme për shkak se me datë 31.03.2023 ka qenë afati i fundit për paraqitjen e kërkesës për shtyrjen e afatit të validitetit të certifikatës, e gjitha kjo e bazuar me Rregulloren Nr.01/2021, përkatësisht në Dispozitat Kalimtare neni 37 par.1. Këtu përcaktohet se certifikatat e Ekspertëve janë valide për dy (2) vite nga hyrja në fuqi e kësaj rregullore dhe e cila ka hyrë në fuqi me datë 01.04.2021, dhe rrjedhimisht me këto dispozita rregullohet se zyrtarët të cilët nuk kanë ndjekur udhëzimet e nevojshme atëherë certifikata e tyre është e pavlefshme. Pra, ne vlerësojmë se ky krahasim i ofertave është i padrejtë dhe diskriminues ndaj tjerëve.

Eksperti Shqyrtues sa i përket pretendimit të OE ankues sqaron se, në listën e publikuar nga Ministria e punës dhe mirëqenies sociale, gjendet emri i zyrtarit i cili është i potencuar nga OE i rekomanduar si Menaxher për shëndet dhe siguri në punë, **dhe si etillë pretendimi nuk gjendet i bazuar.**

Tutje, sa i përket qasjes, në ofertën e OE të rekomanduar gjendet aneks 3 kërkesa për konfidencialitet, ku AK duhet që të klasifikoj informatat sekrete afariste, të cilat konsideron se mund ta dëmtojnë operatorin ekonomik në ofertë, mirëpo per pjesën tjetër duhet qe ti ipet qasja, **andaj pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërishtë e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Security Code**

Blerina Huruglica